



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.242, datë 29.09.2022

PËR

“MIRATIMIN E RELACIONIT MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS  
TË KANDIDATES PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT  
FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS,  
NË VITIN AKADEMIK 2022-2023,  
ZONJA MIKLEVANA QEMA”

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2/a dhe 161, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 32, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Seksionin VI dhe Seksionin VII, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, miratuar me Vendimin Nr.171, datë 27.9.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, zonjës Miklevana Qema”, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës zonjës Miklevana Qema, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatës për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2022-2023.
3. Të njoftohet për këtë vendim zonja Miklevana Qema dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 29.09.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj



ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Elaida Goxhi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirela Bogdani